



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I SHERBIMEVE DHE STREHIMIT SOCIAL, SHENDETESISE DHE
BARAZISE GJINORE

RAPORT VENDIMARRJE

Nr 3, Datë 29/08/2025

Lënda: Vendim për shqyrtimin e projekt-vendimit nr.....datë,/...../2025
"Mbi miratimin e Planit Vendor Social 2025-2028"

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Elbasan

Hyrje

Ky projekt-vendim paraqitet nga Drejtoria e Pergjithshme e Kujdesit Social, Arsimit dhe Rinise, dhe Sporteve, dhe ka për qëllim:

BAZUESHMERIA LIGJORE DHE VOTIMI	Referuar relacionit te projektvendimit
SITUATA AKTUALE E FUNKSIONIT	Në zbatim të parimeve të qeverisjes vendore, në përputhje me prioritetet e politikave sociale kombëtare dhe në funksion të nevojës për përmirësimin e vazhdueshëm të mekanizmave të mbrojtjes sociale në nivel vendor, Bashkia Elbasan ka ndërmarrë një proces rishikimi të Planit Vendor të Veprimt të Mbrojtjes Sociale 2024-2027. Arsyet e rishikimit: 1. Ndryshimet sociale dhe demografike Në vijim të analizave të kryera nga strukturat e Bashkisë dhe institucioneve partnere: Është vërejtur një ndryshim në përbërjen demografike të popullsisë, përfshirë rritjen e përqindjes së grupmoshave të moshuara, si dhe zhvendosjen e popullsisë nga zonat rurale drejt zonave urbane. Janë konstatuar rritje të rasteve të vulnerabilitetit social, të lidhura me faktorë ekonomikë, papunësinë, ndryshimet në strukturën familjare, emigracionin etj; Është htë en nevojshme të përditësohen prioritetet dhe masat ndërhyrëse, për të qenë në përputhje me realitetin e ri shoqëror dhe për të ofruar shërbime më efektive dhe gjithëpërfshirëse; 2. Shtesë specifike për pakicat rome dhe egjiptiane Nisur nga fakti që Planit Vendor i Veprimt të Mbrojtjes Sociale aktual 2024-2027 nuk kishte të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I SHERBIMEVE DHE STREHIMIT SOCIAL, SHENDETESISE DHE
BARAZISE GJINORE

	<i>përfshirë masa që mundësojnë integrimin e pakicave rome e egjiptiane si pasojë e ekzistencës së Planit Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022 (miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 43, më 30 prill 2020), u pa e nevojshme përfshirja e masave për integrimin e këtyre pakicave në Planin Vendor të Veprimit të përfaqësues të organizatave që punojnë me pakicat rome dhe egjiptiane:</i> <i>Është identifikuar nevoja për një përfshirje më të gjerë dhe të thelluar të këtyre komuniteteve në politikat dhe programet sociale të Bashkisë.</i> <i>Plani i rishikuar parashikon një shtojcë të dedikuar për pakicat rome dhe egjiptiane, ku përfshihen masa të posaçme për përmirësimin e aksesit në shërbime sociale, regjistrim civil, kujdes shëndetësor, strehim social, arsim dhe punësim; Përmbajtja e rishikimit ruan strukturën bazë të dokumentit fillestar, por përfshin:</i> <i>Përditësimin e të dhënave statistikore:</i> <i>Rishikimin e objektivave strategjike dhe veprimeve prioritare;</i> <i>Shtojcën për pakicat rome dhe egjiptiane;</i> <i>Masa të reja për përfshirjen e të rinjve, grave në nevojë, personave me aftësi të kufizuara, dhe të moshuarve.</i> <i>Ky rishikim synon të rrisë efektivitetin, gjithëpërfshirjen dhe qëndrueshmërinë e politikave të mbrojtjes sociale në nivel vendor. Plani është hartuar në bashkëpunim me aktorë lokalë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe komunitetet në nevojë, duke reflektuar një qasje sa më afër realitetit dhe nevojave të qytetarëve.</i>
SITUATA FINANCIARE (Impakti financiar, shtesa pakësime në buxhet)	<i>Te gjitha kostot e planit do të llogariten në muajt në vazhdim dhe do të pasqyrohen në programin buxhetor afat-mesem (PBA) 2026-2028.</i> <i>Financimi i planit do të mbështetet në burime të kombinuara nga buxheti vendor, dhe nga</i>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I SHERBIMEVE DHE STREHIMIT SOCIAL, SHENDETESISE DHE
BARAZISE GJINORE

	<i>bashkëpunimi me partnerë zhvillimi, organizata dhe donatorë.</i>
DREJTORIA PËRGJEGJËSE	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Kujdesit Social, Arsimit dhe Rinise dhe Sporteve</i>
RAPORTIMI DHE MONITORIMI	<i>Plani përmban mekanizma të qartë të monitorimit, tregues matës të progresit dhe ndikimit, raportim vjetor, rishikim afatmesëm dhe pjesëmarrje të aktorëve lokalë dhe komunitetit në vlerësim.</i>
IMPAKTI SOCIAL DHE GRUPET QË PREKEN	<i>Plani i rishikuar parashikon masa të posaçme për përmirësimin e aksesit në shërbime sociale, regjistrim civil, kujdes shëndetësor, strehim social, arsim dhe punësim. Përmbajtja e rishikimit ruan strukturën bazë të dokumentit fillestar, por përfshin edhe përditësimin e të dhënave statistikore, rishikimin e objektivave strategjike dhe veprimeve prioritar, shtojcën për pakicat romë dhe egjiptiane, dhe masa për përfshirjen e të rinjve, grave në nevojë, personave me aftësi të kufizuara, dhe të moshuarve.</i>
KONSULTIMI PUBLIK	<i>Ky projekt vendim kërkon konsultim publik sipas nenit 17 të ligjit 139/2015, të Rregullores së Këshillit. Eshte marre vendimi i Kryesise per kalimin ne konsultim publik te projektaktit. Eshte hartuar dhe publikuar ne fagen e internetit te Bashkise Elbasan, njoftimi dhe kalendari per degjasat publike. Eshte realizuar nje degjese me publikun date 26/08/2025, ku kane marre pjese persona. Eshte mbajtur procesverbali i takimit dhe kane dale rekomandimet per konsultimin publik te cilat jane permblodhur dhe i jane derguar Kryetarit te Bashkise per reflektim.</i>

Komisioni i Përhershëm i Sherbimeve dhe Strehimit Social, Shendetesise dhe Barazise Gjinore, i mbledhur më datën 26/05/2025 pasi shqyrtoi Projekt-vendimin, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ti propozojë Këshillit Bashkiak:

a. Kalimin e projekt aktit në mbledhjen e këshillit për vlerësim të mëtejshëm për vlerësim dhe miratim.

b. Miratimin e projektaktit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I SHERBIMEVE DHE STREHIMIT SOCIAL, SHENDETESISE DHE
BARAZISE GJINORE

- c. Refuzimin e miratimit të Projektaktit
- d. Ti kerkoje drejtorise perkatese informacion shtese per projektvendimin
- e. Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
 - Pika e projektvendimit të ndryshojë në “_____”
 - Pika e projektvendimit të ndryshojë në “_____”
 - Tabela e projektvendimit të ndryshojë në “_____”
 - Paragrafi i projektvendimit të ndryshojë në “_____”

Bashkëlidhur argumentat e Vendimarrjes dhe mendimi i pakicës i parqitur në procesverbalin e Komisionit

Kryetari i Komisionit: Rexhep Kaçuli

Nenkryetare e Komisionit: Aurora Domni

Sekretare e Komisionit: Luiza Popja

Anetar i Komisionit: Jana Zeqiri

Anetar i Komisionit: Enrieta Ferra

Anetar i Komisionit: Valbona Balliu

Anetar i Komisionit: Artan Kana

Elbasan, më: 28/08/2025